

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës :

Specialist i Çështjeve të Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë,-AKEP

Procedura : **PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINE EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emerimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se do të vazhdojnë konkurimin në procedurën pranim në shërbim civil në kategorinë ekzekutive:

- **Z. Arsen Çaçi**
- **Z. Elis Gruda**
- **Znj. Sabina Cenaj**

- **Konkurimi:**
 - **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **25.11.2019** ora **09:30**.
 - **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **25.11.2019** ora **12:00**.

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv në AKEP- KPP, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist i Çështjeve të Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë** .

Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emerimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **25.11.2019**.

Njoftimi do të bëhet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **02.12.2019**.

Njësia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)